

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6176
E premte, 27 nëntor 2020
çmimi 0.40 €

Kuvendi i Shqipërisë themelon komisionin e posaçëm për raportin e Dick Martyt



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KËRKOHET MARRËVESHJE E GJERË PËR PRESIDENTIN E RI

PARTITË, ENDE TË NDARA PËR POZITËN E PRESIDENTIT



Temë e zgjedhjes së presidentit të ri është hapur, por partitë politike janë të ndara rreth kësaj teme. Pozita dhe opozita ende nuk janë takuar për të diskutuar për këtë çështje, ndërsa në qëndrimet e tyre publike kanë treguar pretendimet për të parin e vendit. Analistët politikë kanë bërë me dije se subjektet politike duhet ta gjejnë një zgjidhje për pozitën e presidentit të ri pa e çuar vendin në zgjedhje të reja. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka paralajmëruar për javën e ardhshme një takim të liderëve për këtë temë, duke kërkuar marrëveshje të gjerë për zgjedhjen e presidentit të ri

COVID-19 NË KOSOVË, 15 VIKTIMA DHE 775 RASTE TË REJA

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar të enjten se gjatë 24 orëve të fundit 15 pacientë kanë vdekur dhe janë regjistruar 775 raste të

reja me Covid-19. IKShPK-ja po ashtu ka bërë me dije gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar edhe 553 pacientë, duke çuar në total 22 690 numrin e të shëruarve



AKTUALE



SHQIPËRIA, NJË VIT PAS TËRMETIT

EKATERINA TRENDAFILOVA RIEMËROHET KRYETARE E DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

OSMANI SHFUQIZON DEKRETET PËR KONSUJT NË PRAGË, LUBJANË, SHKUP E TIRANË

EKONOMI



KOSOVA ANËTARËSOHET NË RRJETIN EVROPIAN GEANT

QEVERIA MIRATON KURSIMET DHE RISHPËRNDARJEN E MBI 47 MILIONË EUROVE PËR VITIN 2020

KULTURË

KOMPLETI I VEPRAVE TË ANTON ÇETTËS PËRMBAN 13 VËLLIME



KOSOVA DHE SERBIA ME MARRËVESHJE PËR PEZULLIMIN E VIZITAVE

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepgisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Shqipëria, një vit pas tërmetit

TIRANË, 26 NËNTOR- Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama e ka nisur mëngjesin e e së enjtes me një mesazh për shqiptarët që kaluan një tmerr të vërtetë një vit më parë, ku orët e para të mëngjesit të 26 nëntorit u goditën nga tërmeti që la pas 51 viktima dhe mijëra banesa të shkatërruara. “I paharruar kujtimi i viktimave të tragjedisë së një viti më parë. Më e keqja është pas krahëve dhe më e mira është e gjitha përpara nesh”, ka shkruar Rama në llogarinë e vet në “Facebook”.

Mëngjesi i 26 nëntorit ku vendi u trondit nga një tërmet me magnitudë 6.4 të shkallës rihter la një plagë të pashërueshme për familjet dhe të afërmit e 51 viktimave të tij. Qindra të lënduar, la pas ajo dridhje e fuqishme e tokës, kryesisht në Durrës, Kurbin, Tiranë e Lezhë. Shembje pallatesh, shtëpish, shkolla e institucione të tjera. Thirrjet dëshpëruese të familjareve që të afërmit i kishin nën rrënoja, sirenat e autoambulancave, policisë, zjarrfikësve, ushtrisë,

ushtonin ngado. Mbi 200 mijë persona u preken direkt nga dëmet që la pas. Shqipëria u kthye menjëherë në qendër të raportimeve të medieve botërore. Shqiptarët, fqinjët, partnerët nisen mobilizimin e shpejtë për t'i ardhur në ndihmë Shqipërisë. Sot një vit më pas, pasojat janë ende të freskëta, pasojat e atij tërmeti shkatërrimtar, për jetët e humbura dhe për gjendjen në të cilën ndodhen qytetarët që kanë humbur banesat e tyre.



Kuvendi i Shqipërisë themelon komisionin e posaçëm për raportin e Dick Martyt

Tiranë, 26 nëntor- Me 83 vota pro, 10 kundër dhe 10 abstenim, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar kërkesën për ngritjen e Komisionit të posaçëm për raportin e Dick Marty, i cili implikonte UÇK-në. Ky komision ka nisur me iniciativën e kryetarit të grupit parlamentar të Partisë Socialiste (PS), Taulant Balla, ku më pas është depozituar kërkesa për ngritjen e një komisioni të posaçëm që do të marrë në shqyrtim të gjitha pretendimet e ngritura më rezolutën e KiE prej senatorit Dick Marty. Me këtë rast, Balla nga foltorja e Kuvendit ka folur

për ngritjen e Komisionit të posaçëm, i cili do të hetojë akuzat e raportit të Dick Marty, sipas të cilit në Shqipëri janë kryer krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, në kuadër të luftës së UÇK-së në Kosovë. Në kërkesën drejtuar Kuvendit të Shqipërisë firmosur nga 18 deputetë socialistë është thënë se: “Ngritja e një Komisioni të posaçëm të Kuvendit të Shqipërisë për administrimin e dokumentacionit dhe hartimin e një raporti përmbledhës dhe informues mbi gjetjet dhe konkluzionet që kanë nxjerrë verifikimet e kryera nga institucionet përkatës në



Shqipëri mbi çështjen e raportit të anëtarit APKiE, Dick Marty, mbi bashkëpunimin dhe rolin për të cilin pretendohet se kanë luajtur përfaqësues politikë shqiptarë ose institucione publike shqiptare, nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve, në ndihmë të së ashtuquajturës veprimtari kriminale e drejtuesve të UÇK-së në Shqipëri”. Ky komision duhet të hartojë një raport të detajuar përmbledhës dhe informues për të gjitha këto çështje dhe t’ia prezantojë Kuvendit të Shqipërisë brenda tre muajve.

Bideni: Ne jemi në luftë me virusin, jo me njëri-tjetrin



WASHINGTON, 26 NËNTOR- Presidenti i zgjedhur i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, ka bërë thirrje për t'i dhënë fund “epokës së zymtë të ndarjes”, pasi vendi përballet me një dimër të gjatë dhe të vështirë me pandeminë e Covid-19. Në një fjalim për festën e Falënderimeve, ai tha se amerikanët janë në luftë me koronavirusin, jo me njëri-

tjetrin. Javën e kaluar më shumë se 1.2 milion raste të reja me koronavirus u regjistruan në Shtetet e Bashkuara. “Unë besoj se ju gjithmonë meritoni të dëgjoni të vërtetën nga presidenti juaj. Ne duhet të ngadalësojmë përhapjen e këtij virusi. Ne ua kemi borxh mjekëve dhe infermierëve dhe punonjësve të vijës së parë të

frontit kundër pandemisë. Ne ua kemi borxh bashkëqytetarëve tanë”, ka thënë Biden. Ai ka shtuar se Covid-19 ka shkakuar shumë dhimbje, humbje dhe zhgënjim. “Na ndau, na zemëroi, na vendosi kundër njëri-tjetrit. Unë e di që vendi është lodhur nga lufta, por duhet të kujtojmë se ne jemi në luftë me virusin, jo me njëri-tjetrin”, ka deklaruar Biden.

Greqia zgjat për një javë izolimin mbarëkombëtar

ATHINË, 26 NËNTOR- Greqia do të zgjasë masën e izolimit mbarëkombëtarë, për një javë, deri më 7 dhjetor, teksa rastet me Covid-19 vazhdojnë të rriten, thanë zyrtarët qeveritarë. Rritja e rasteve të reja me Covid-19

në Greqi po ndodh që prej muajit tetor, që ka detyruar qeverinë që të shpallë izolim mbarëkombëtar për të dytën herë që prej fillimit të pandemisë. Greqia deri më tani ka regjistruar 97,288 raste me

Covid dhe 1 902 viktima. Pjesa veriore e vendit është goditur më së keqi, ku edhe spitalet janë të stërmëshura me pacientë. Pavarësisht “indikacioneve të para” se numri i rasteve ditore po ulet, Greqia do të jetë në gjendje të

planifikojë rikthimin në normalitet kur sistemi i saj shëndetësor të mos ketë fluks të madh të pacientëve, tha zëdhënësi i Qeverisë greke, Stelios Petsas. “Tash për tash, ne do t’i zgjasim masat kufizuese që janë vendosur



kundër pandemisë, deri të hënën e 7 dhjetorit”, ka deklaruar Petsas.

Kosova dhe Serbia me marrëveshje për pezullimin e vizitave



PRISHTINË, 26 NËNTOR- Kosova dhe Serbia javën e kaluar kanë arritur një “marrëveshje mirëkuptimi” për të pezulluar vizitat e ndërsjella, për aq kohë sa do të zgjasin gërmimet në varrezat e dyshuara masive, ku dyshohet se janë varrosur civilët shqiptarë, të vrarë gjatë luftës së fundit në Kosovë. Kjo marrëveshje, sipas burimeve nga Bashkimi Evropian, u bë menjëherë, pasi autoritetet në Prishtinë

refuzuan kërkesën për vizitë të zyrtarëve të lartë serbë. Zëdhënësi i BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Peter Stano ka konfirmuar se është arritur një pajtim i mirëbesimit, por nuk ka saktësuar për çfarë palët kanë rënë dakord. “Ne nuk komentojmë marrëveshje diplomatike apo të mirëkuptimit, të cilat i ka ndërmjetësuar BE-ja me apo mes partnerëve tanë. Por, në këtë rast konkret, mund të

konfirmoj, pa hyrë në detaje, se ne kemi ndërmjetësuar një mirëkuptim të tillë mes Kosovës dhe Serbisë lidhur me vizitat e ndërsjella”, ka deklaruar Stano. Mësohet se marrëveshja u arrit përmes përfaqësuesit të posaçëm për dialogun, Miroslav Lajçak, dhe ai parashikoi që palët të përmbahen nga kërkesa për vizita në Serbi ose Kosovë. Por, një zyrtar i BE-së tha për “Radion Evropa e Lirë” në

kushte anonimiteti se “ministrja e Kosovës (Meliza Haradinaj-Stublla) e shkeli konfidencialitetin e kësaj marrëveshjeje brenda pak orësh, dhe kjo është arsyeja pse BE-ja doli në publik, dhe konfirmoi ekzistencën e një marrëveshjeje për të cilën nuk duhej të flitej në publik”. Siç u shpjegua në selinë e BE-së, iniciativa për këtë marrëveshje u nis për shkak të “nxitimit të papritur të kërkesave” të

paraqitura për vizita në Kosovë dhe Serbi, në kohën kur filluan gërmimet në një vend ku dyshohet për një varrezë masive të shqiptarëve të Kosovës të vrarë gjatë luftës.

Logjika e kësaj iniciative evropiane, siç u tha, është që vizita të tilla do të provokojnë tensione dhe emocione.

Sipas burimeve, kishte tre kërkesa nga Serbia për të vizituar Kosovën, përfshirë edhe ajo e presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, një kërkesë nga Kosova për të vizituar Serbinë. Burimet e REL-it konfirmuan se pala serbe gjithashtu ra dakord “në heshtje” të tërheqë kërkesën për një vizitë. Të enjten kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka konfirmuar se ka pranuar një letër nga i dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun Kosovë-Serbi, në të cilën atij i kërkohet që Kosova të respektojë marrëveshjen për lëvizjen e lirë të arritur në Bruksel. “Kosova është pro lëvizjes së lirë dhe po punojmë në kuadër të dialogut që të përmbyllin gjitha çështjet e hapura me Serbinë. Unë kam pranuar letrën nga Lajçak dhe jam në komunikim të rregullt me të, por çdo kërkesë për vizitë do të trajtohet në kontekst të ndjeshmërisë së situatës nëpër të cilën po kalojmë”, ka thënë kryeministri Hoti, gjatë një paraqitjeje para gazetarëve në Prishtinë.

Osmani shfuqizon dekretet për konsujt në Pragë, Lubjanë, Shkup e Tiranë

PRISHTINË, 26 NËNTOR (ER)- Ushtruesja e detyrës së presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani ka shfuqizuar katër dekrete për konsujt të përgjithshëm, konkretisht për konsujt në Pragë, Lubjanë, Shkup dhe Tiranë.

Dekretet ishin nënshkruar nga ish-presidenti, Hashim Thaçi. “Për tri rastet e para (Pragë, Lubjanë, Shkup), bazuar në praktikën diplomatike e konsullore, konsullatat e përgjithshme, si rregull, nuk hapen dhe konsujt e përgjithshëm nuk emërohen në të njëjtin qytet ku ndodhet edhe Ambasada. Për më tepër, bazuar në informatat që na janë dërguar, për këta konsujt të përgjithshëm nuk kishte pëlqim nga shteti pritës”, thuhet në njoftimin e presidentes, në të cilin sqarohet se për konsullin në Tiranë, Osmani ka vendosur ta shfuqizojë dekretin, në përputhje me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Këtë vendim, Osmani e kishte paralajmëruar të mërkurën pasi mediet lokale raportuan për emërimin e Flakron Shalës, djalit të deputetit Haxhi Shala, si Konsull i Përgjithshëm në Pragë. Vota e Haxhi Shalës ka qenë vendimtare në votimin e qeverisë aktuale të drejtuar nga Avdullah Hoti.

Gjatë seancës së Kuvendit të Kosovës, kur është votuar për qeverinë e re, deputeti Shala pati deklaruar se ai ka ndryshuar mendimin për ta votuar qeverinë, pasi një natë më parë kishte takuar ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçin dhe kryetarin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj. Emërimi i Flakron Shalës në këtë pozitë ishte kundërshtuar edhe nga shoqëria civile në Kosovë.

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti ka thënë të mërkurën se ky emërim ishte bërë pa pasur një koordinim me të. Ai ka pohuar se është



informuar nga mediet për këtë rast.

Ndërsa vetë Flakron Shala përmes një postimi në rrjetet sociale ka thënë se në pozitën Konsullit të Përgjithshëm është “emëruar sipas ligjit në fuqi”. “Prindi im, Haxhi Shala, si një deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk ka

as më shumë e as më pak autoritet ligjor e politik se deputetët tjerë, pra deputeti nuk ka kompetencë të emërojë apo shkarkojë zyrtarët e MPJ-së dhe as konsujt e përgjithshëm”, ka shkruar Shala.

Të shkarkuarit tjerë janë: Blendi Kilaj (Lubjanë), Lindon Kqira (Shkup) dhe Halim

Krasniqi (Tiranë).

Ushtruesja e detyrës së presidentit, Vjosa Osmani, ka thënë përmes komunikatës për medie se “si udhëheqëse e politikës së jashtme, është e përkushtuar që të mbrojë ligjshmërinë dhe profesionalizmin përgjatë emërimeve në shërbimin e jashtëm”.



KËRKOHET MARRËVESHJE E GJERË PËR PRESIDENTIN E RI

PARTITË, ENDE TË NDARA PËR POZITËN E PRESIDENTIT

Temë e zgjedhjes së presidentit të ri është hapur, por partitë politike janë të ndara rreth kësaj teme. Pozita dhe opozita ende nuk janë takuar për të diskutuar për këtë çështje, ndërsa në qëndrimet e tyre publike kanë treguar pretendimet për të parin e vendit. Analistët politikë kanë bërë me dije se subjektet politike duhet ta gjejnë një zgjidhje për pozitën e presidentit të ri pa e çuar vendin në zgjedhje të reja. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka paralajmëruar për javën e ardhshme një takim të liderëve për këtë temë, duke kërkuar marrëveshje të gjerë për zgjedhjen e presidentit të ri

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 26 NËNTOR - Subjektet politike janë të ndara në qëndrime për pozitën e presidentit. Ndonëse ende nuk janë takuar për të diskutuar rreth kësaj çështje, në qëndrimet publike shihet se janë larg arritjes së një

konsensusi për pozitën e të parit të shtetit.

Njohësit e rrethanave politike kanë bërë me dije se partitë politike duhet të heqin dorë nga interesat e ngushta partiake dhe ta shikojnë mundësinë e gjetjes së një figure konsensuale për këtë pozitë, por disa parti politike insistojnë ta kenë për vete këtë

pozitë.

Analisti politik Behxhet Shala ka thënë për "Epokën e re" se subjektet politike duhet të ulen dhe ta arrijnë një marrëveshje për këtë çështje sa më shpejt. "Realisht e kemi një situatë politike e cila kërkon zgjidhje. Sipas meje, partitë politike duhet të ulen dhe të bëjnë përpjekje për ta zgjedhur

presidentin. Në qoftë se nuk arrijnë një marrëveshje procedurale për presidentin, atëherë partitë politike do të duhej të merren vesh për datën e zgjedhjeve të cilat do të duhej të mbaheshin jo më herët se në muajin qershor të vitit 2021", ka thënë Shala, duke shtuar se për shkak të situatës dhe të procedurave, është e pamundur të mbahen zgjedhjet para kësaj kohe. "Në anën tjetër, e kemi një situatë ku disa parti politike janë të interesuara t'ia shkurtojnë mandatin ushtrueses së detyrës së presidentes, ndërsa disa të tjera janë të interesuara që Vjosa Osmani të qëndrojë në këtë pozitë. Unë mendoj se disa parti do të bëjnë përpjekje maksimale që ta gjejnë një kandidat për president në mënyrë që ta nxjerrin Vjosa

Osmanin nga zyra e presidentit, të cilën në asnjë mënyrë nuk mund ta paramendojnë në atë zyrë qoftë edhe si ushtruese e detyrës së presidentit. Pra ata do të bëjnë përpjekje që ta zgjedhin presidentin e ri", ka thënë ai.

Edhe analisti tjetër Shkëlzen Maliqi ka deklaruar për gazetën se partitë politike duhet të reflektojnë ndaj situatës dhe të heqin dorë nga interesat e ngushta. "Në kohën e pandemisë partitë politike po sillen në mënyrë krejtësisht të gabuar dhe pa koordinim substancial që diktohet nga interesi vital i mbrojtjes së shëndetit kombëtar dhe ekonomisë së shtetit dhe kështu po vazhdojnë edhe në raport me gjykimin në Hagë. Mirëpo besoj se situata do t'i

kthjellë shpejt, sepse nuk ka më hapësirë manovruese për konfrontimet që në plan të parë nxjerrin interesat e partive, të grupeve dhe të liderëve të caktuar, e jo ato të përgjithshme”, ka thënë Maliqi. Sipas tij, zgjedhjet janë të pashmangshme, por jo menjëherë. “Mendoj je zgjedhjet janë të pashmangshme, por jo menjëherë dhe jo as në pjesën e parë të vitit të ardhshëm, jo vetëm për shkak të pandemisë, por duhet edhe një lloj stabilizimi i brendshëm i raporteve. Koalicioni më i gjerë qeverisës do të mund të kontribuonte në këndellje, por me premtim që të mbahen zgjedhjet e reja pasi që të krijohen kushtet më të volitshme”, ka vlerësuar ai.

LDK-ja kërkon marrëveshje të gjerë për presidentin

Ditë më parë kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ka paralajmëruar thirrjen e një takimi me liderët e partive politike për arritjen e një marrëveshjeje për zgjedhjen e presidentit të ri të vendit. Ai ka thënë se zgjedhjet e jashtëzakonshme nuk janë opsion. Mustafa ka thënë se javën që vjen do të takohen me partitë politike për të diskutuar edhe për këtë temë. “Nuk kemi biseduar për presidentin ende. Por, sipas nesh, çështja e presidentit duhet të zgjidhet sa më shpejt e jo të shkojmë në zgjedhje. Në fillim të dhjetorit do të mblidhemi me kryesinë për të biseduar për presidentin”, ka thënë Mustafa. Deri më tash vetëm lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka

shprehur hapur synimin për t’u bërë president i vendit, por ai nuk është mbështetur nga LDK-ja dhe partnerët e tjerë të koalicionit qeverisës. Përfaqësuesit e AAK-së kanë thënë në vazhdimësi se nëse kandidati i tyre nuk zgjedhet president atëherë do të shkohet në zgjedhje të parakohshme parlamentare.

Edhe partitë opozitare, LV-ja dhe PDK-ja, ia kanë bërë me dije AAK-së se nuk kanë votë për Haradinajn për president. PDK-ja i ka shprehur ambiciet për këtë pozitë, duke lënë të kuptohet se vetëm duke marrë pozitën e shefit të shtetit mund të bëhet pjesë e koalicionit qeverisës.

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Sejdi Hoxha, ka thënë se presidenti duhet të propozohet nga PDK-ja. “PDK-ja i mirëpret të gjitha kandidatit e mundshme për president. Ne kemi një rrethanë që PDK-ja në zgjedhjet e fundit ka dalë me 24 deputetë dhe LDK-ja e LV-ja e ndërtuan qeverinë. Ata brenda tre muajve i kanë dhënë fund bashkëpunimit të tyre dhe tani kemi një qeveri të udhëhequr nga LDK-ja, AAK-ja dhe Nisma. Pikërisht që ne e ruajmë konsistencën tonë politike, ishim në opozitë dhe po vazhdojmë të jemi në opozitë”, ka thënë Hoxha, duke shtuar se presidenca duhet t’i takojë pikërisht kësaj partie. “Parimisht është shumë e përgjegjshme dhe e udhës që PDK-ja ta udhëheqë Presidencën dhe ta ketë presidentin”, ka thënë ai. Kurse partia më e madhe në vend, LV-ja, ka bërë me dije se çështja e presidentit duhet të diskutohet vetëm pas zgjedhjeve të reja

parlamentare.

Albulena Haxhiu nga Vetëvendosja ka thënë se nuk e kupton pse partive të tjera po iu ngutet në lidhje me presidentin, pasi Kosova ka Vjosa Osmanin si ushtruese e detyrës së shefes së shtetit. “Çështja e presidentit është duke u diskutuar më të madhe dhe pa nevojë. Kosova e ka tashmë ushtruesin e detyrës së presidentit. Vetëvendosja nuk e mbështet asnjë kandidat për president pa u mbajtur zgjedhjet e përgjithshme dhe pa pasur një udhëheqje të re”, ka thënë Haxhiu.

Kosovës i duhet një qeveri më e gjerë

Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, ka thënë se vendit urgjentisht i duhet një qeveri e unitetit, në të cilën do të përfshiheshin partitë politike parlamentare. Ajo ka thënë për gazetën “Epoka e re” se në momente strategjike për vendin ka ndodhur një lloj uniteti, ku Kosova ishte e fortë për realizimin e synimeve të veta. “Kosova është në një gjendje shumë të rëndë në përgjithësi, në njërin anë për shkak të pandemisë dhe inicimi i proceseve nga Gjykata Speciale e ka rënduar këtë gjendje edhe më shumë. Kjo gjendje kërkon një mobilizim më të madh të institucioneve të shtetit tonë. E para për të siguruar një mbrojtje shtetërore sa më të mirë për ata që janë në gjykatë, në mënyrë që argumentimi të bëhet me një mbështetje sa më të madhe institucionale”, ka thënë Tahiri. Sipas saj, një qeveri e tillë do të ishte e nevojshme edhe për procesin e

dialogut me Serbinë. “Mendoj se fillimisht duhet të formohet një qeveri e unitetit dhe pastaj në një konsultë serioze ndërmjet të gjitha palëve, edhe me aleatët tanë, ShBA-në dhe Evropën, të vendoset në lidhje me ardhmërinë e këtij dialogu. Kosova duhet të jetë e zonja që t’ua bëjë të qartë partnerëve dhe miqve tanë ndërkombëtarë, se nëse Serbia nuk e ka ndërmend ta njohë pavarësinë e Kosovës dhe e shfrytëzon këtë dialog për të treguar se gjoja është konstruktive për ta përparuar agjendën e vet evropiane, atëherë ky dialog po kthehet në një proces të dëmshëm për Kosovën. Këto çështje i takojnë Qeverisë së Kosovës me partnerët ndërkombëtarë para se të merren vendime çfarëdo qofshin në raport me dialogun”, është shprehur Tahiri.

Edhe analisti politik Shkëlzen Maliqi mendon se një qeveri

më e gjerë është e nevojshme për dialogun me Serbinë. “Po kështu, një qeveri më e gjerë na duhet edhe për shkak të dialogut, të cilin nuk duhet ta lëshojmë me fajin tonë ose duke çuar inate. Kjo për arsye se ende ka një fije arsye të besohet se edhe BE-ja dëshiron që ta mbyllë dialogun me sukses dhe njohje të ndërsjellë. Duhet të jemi të kujdesshëm në kërkesat për ndërprerjen e dialogut, të paktën derisa nuk kemi një qeveri të re funksionale në ShBA”, ka thënë Maliqi.

Partnerët e koalicionit kanë edhe pesë muaj kohë për arritjen e pajtimit për zgjedhjen e presidentit të ri të vendit, pozitë kjo që u bë pjesë e kalkulimeve politike pas konfirmimit të aktakuzës për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit ndaj ish-presidentit Hashim Thaçi, i cili dha dorëheqje më 5 nëntor.



Hoxhaj, ambasadorit italian: Lufta e drejtë e UÇK-së krijoi rrethana të reja

PRISHTINE, 26 NËNTOR (ER)- Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka pritur të enjten në takim ambasadorin Italian, Nicola Orlando, me të cilin kanë biseduar edhe për situatën aktuale në Kosovë, përfshirë Gjykatën Speciale, pandeminë dhe krizën institucionale e politike.

Hoxhaj ka bërë me dije se ambasadorin Italian, Nicola Orlando, në takim e ka pritur bashkë me anëtarin e Kryesisë së PDK-së, Blerta Deliu Kodra. “Italia që nga viti 1999 gjithnjë ishte në krah të Kosovës dhe të luftës së saj të drejtë. Lufta e drejtë e UÇK-së krijoi rrethana të reja, në të cilat Kosova aspiroi dhe vazhdon të aspirojë vlerat evropiane për ndërtimin e një shoqërie demokratike e të sigurt për të gjithë qytetarët”, ka

shkruar Hoxhaj në llogarinë e vet në “Facebook”.

Më tutje, ai i ka thënë se pashmangshëm, me ambasadorin italian kanë biseduar edhe për situatën rreth pandemisë Covid-19, duke konstatuar se kjo situatë duhet të menaxhohet me sa më shumë përgjegjësi dhe angazhim me të gjitha kapacitetet institucionale e njerëzore. “Bashkëpunimi midis dy vendeve tona do të vazhdojë edhe më tej, për ta jetësuar, tani, anëtarësimin e Kosovës në familjen evropiane. Pashmangshëm, biseduam edhe për situatën rreth pandemisë Covid-19, duke konstatuar se kjo situatë duhet të menaxhohet me sa më shumë përgjegjësi dhe angazhim me të gjitha kapacitetet institucionale e njerëzore”, ka shkruar Hoxhaj.



Komuna e Prishtinës do të ndihmojë financiarisht të infektuarit me Covid-19



PRISHTINË, 26 NËNTOR (ER)- Kuvendi Komunal i Prishtinës ka miratuar vendimin për të ndihmuar financiarisht të infektuarit me Covid-19.

Kryetari i Komunës, Shpend Ahmeti përmes një postimi në rrjetin social "Facebook" ka njoftuar se çdo banor i kryeqytetit që është konfirmuar pozitiv në koronavirus do të marrë një ndihmë prej 50 euro, ndërsa për pensionistët që dalin pozitiv në koronavirus, kjo shumë do të jetë 100 euro. Sipas Ahmetit, komuna do të ndihmojë edhe me ilaçe të cilat po përdoren për trajtimin e të sëmurave me Covid-19. "Kam udhëzuar drejtorin e

Shëndetësisë që të fillojë procedurat e prokurimit të shpejtë për një numër barnash që mjekët po i përshkruajnë për Covid-19, e që nuk janë të ofruara nga sistemi jonë shëndetësor. Po ashtu edhe për blerjen e testeve D-Dimer që mjekët po e kërkojnë për shkak të trombeve të mundshme. Këto barna do të mbulojnë rreth 8.000 pacientë me simptoma pak më të theksuara, pa paguar privatisht", ka shkruar Ahmeti.

Që nga fillimi i pandemisë, Prishtina ka qenë qyteti që ka regjistruar numrin më të lartë të të infektuarve me koronavirus, në baza ditore.

Kompleti i veprave të Anton Çettës përmban 13 vëllime

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 NËNTOR- Në 100-vjetorin e lindjes së Anton Çettës dhe në 25-vjetorin e vdekjes së tij, në ambientet e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, në organizim të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në bashkëpunim me Institutin Albanologjik të Kosovës, është promovuar botimi i kompletit të veprave të veprimtarit, shkrimtarit, mbledhësit të folklorit shqiptar, profesor Anton Çettës.

Muaji nëntor me vendim të qeverisë është shpallur muaji i Anton Çettës me propozim të ministres Vlora Dumoshi e cila ishte në këtë aktivitet bashkë me kryeministrin e Kosovës, Avdullah Hoti, drejtorin e Institutit Albanologjik, Hysen Matoshi, vajzat e Anton Çettës, Donika dhe Agata, dhe shumë personalitete tjera. Aktiviteti në fjalë u shënuar në kuadër të këtij muaji.

Kryeministri Avdullah Hoti, duke vlerësuar lartë kontributin e Çettës, tha se ai së bashku me ish-presidentin Ibrahim Rugova kanë bërë histori moderne. "Përgëzojmë punën që kanë bërë këta hulumtues për personalitetin



me emrin e të cilin identifikohen epokat. E ka ndarë historinë para dhe pas ngjarjes me të cilën Çetta identifikohet, pra me pajtimin e gjaqeve. Ka dhënë kontribut

të jashtëzakonshëm në ndërrimin e kulturës. Ai dhe Rugova kanë bërë histori moderne", ka thënë Hoti. Ndërsa ministrja e Rinisë dhe Sportit, Vlora

Dumoshi, ka thënë se ky aktivitet po shënohet në kuadër të muajit të Anton Çettës, të shpallur nga kryeministri Hoti. Duke e vlerësuar profesorin

Çetta, si një nga studiuesit më serioz të folklorit shqiptar ka themeluar edhe çmimin Anton Çetta. "Viti 2020 shënon 100-vjetorin e lindjes dhe 25-vjetorin e vdekjes së profesorit Anton Çetta. Edhe sot së bashku jemi në aktivitetin e radhës të muajit të Anton Çettës të shpallur nga kryeministri Hoti. Sot promovojmë një pjesë të konsiderueshëm të botimeve të profesorit", ka thënë ministrja Dumoshi, e cila edhe sqaroi se MKRS-ja ka publikuar thirrjen publike për të konkurruar për çmimin Anton Çetta, i cili është themeluar në fushën e trashëgimisë kulturore shpirtërore.

Ministrja Dumoshi falënderoi të gjithë ata që kanë bërë të mundur botimin e kompletit të veprave të profesor Çettës.

Hysen Matoshi drejtor i Institutit Albanologjik, ka thënë se kompleti i veprave të Çettës përmban 13 vëllime e të cilat janë të njohura për lexuesin.

Donika Çetta, vajza e profesor Antonit tha se ky përvjetor i përkujtimit për babanë u erdhi më ndryshe dhe për këtë shprehu mirënjohjen në emër të familjes Çetta për të gjithë ata që mundësuan botimin deh promovimin e veprave të tij.

Hungaria shpreh interesim për të ndihmuar në fushën e kulturës

PRISHTINË, 26 NËNTOR (ER)- Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka takuar të enjten ambasadorin e Hungarisë në Kosovë, Jozsef Bencze, me të cilin ka diskutuar për çështje dhe tema që janë të interesit dypalësh, për marrëdhëniet mes dy shteteve dhe për bashkëpunimin konkret mes Kosovës dhe Hungarisë në

fushat që janë në domenin e ministrisë.

Ministrja Dumoshi e falënderoi ambasadorin Bencze për vizitën, dhe u shpreh se MKRS-ja është e interesuar që të rrisë bashkëpunimin me Hungarinë me veprime dhe projekte konkrete të përbashkëta, sidomos në fushat që lidhen me kulturën, sportin dhe rininë.

Ndërsa ambasadori i Hungarisë në Kosovë, Jozsef Bencze, e falënderoi ministren Dumoshi për pritjen dhe u shpreh se Hungaria është dëshirone që të bashkëpunojë ngushtë me institucionet e Kosovës, dhe në këtë rast, me ministrinë në veçanti për të finalizuar iniciativa dhe realizuar projekte që janë në interesin e dyanshëm.



Covid-19 në Kosovë, 15 viktima dhe 775 raste të reja

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar të enjten se gjatë 24 orëve të fundit 15 pacientë kanë vdekur dhe janë regjistruar 775 raste të reja me Covid-19. IKShPK-ja po ashtu ka bërë me dije gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar edhe 553 pacientë, duke çuar në total 22 690 numrin e të shëruarve



AMBULANCA PËR CORONAVIRUS

Zemaj diskuton me ambasadorin austriak për situatën rreth Covid-19

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka pritur të enjten në takim ambasadorin e Austrisë në Kosovë, Christoph Weidinger, me të cilin kanë këmbyer informata për të dy shtetet sa i përket situatës epidemiologjike lidhur me Covid-19, me theks të posaçëm rreth angazhimeve të Qeverisë dhe

Ministrit së Shëndetësisë për menaxhimin e kësaj situatë. Ministri Zemaj tha se "Austria është shtet mik i Kosovës që në çdo kohë dhe sfidë është gjendur pranë, sikurse edhe tash në kohë të pandemisë, me ndihmë e përkrahje të pa rezervë". Ai ka falënderuar ambasadorin për përkrahjen dhe partneritetin e ofruar,

duke ritheksuar se mirëpret bashkëpunimin dhe partneritetin e mëtejme të Austrisë dhe të ambasadorit Weidinger. "Kosova dhe populli i saj janë të bekuar me gatishmërinë që kanë popujt dhe shtetet mike për të na ndihmuar në këtë kohë të vështirë", ka deklaruar ministri Zemaj.

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 26 NËNTOR- Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë, janë testuar gjithsej 1 903 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 775 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar 15 raste të vdekjes si pasojë e Covid-19.

Rastet e vdekjes janë nga komunat: Prizren katër raste (76, 66, 56, 52 vjeç), Prishtinë dy raste (78, 66 vjeç), Ferizaj një rast (78 vjeç), Gjilan një rast (80 vjeç), Klinë një rast (76 vjeç), Suharekë një rast (77 vjeç), Pejë dy raste (71, 64 vjeç), Vushtrri një rast (72 vjeç), Gjakovë një rast (69 vjeç)

dhe Podujevë një rast (87 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 37 028 raste nga 137 872 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 963 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 553 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 22 690 raste, kurse numri i rasteve aktive është 13 375.

Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 306 raste, Mitrovicë 64 raste, Gjakovë 40 raste, Ferizaj 38 raste, Fushë-Kosovë 37 raste, Gjilan 35 raste, Prizren 30 raste, Podujevë 29 raste, Vushtrri 21 raste, Lipjan 20 raste, Pejë 20 raste, Viti 20 raste, Obiliq 16 raste, Drenas 15 raste, Skenderaj 13 raste, Kaçanik 12 raste, Shtime 11 raste, Suharekë 9 raste, Malishevë 7 raste, Klinë 5 raste, Rahovec 5 raste, Deçan 4 raste, Istog 4 raste, Kamenicë 4 raste, Dragash 3 raste, Graçanicë 2 raste, Novobërdë 2 raste, Zubin-Potok 2 raste dhe Junik 1 rast.

Ekaterina Trendafilova riemërohet kryetare e Dhomave të Specializuara të Kosovës

PRISHTINË, 26 NËNTOR- Ekaterina Trendafilova është riemëruar kryetare e Dhomave të Specializuara të Kosovës edhe për katër vjetet e ardhshëm.

Në një njoftim të Dhomave thuhet se autoriteti emëruar, ambasadori Lars-Gunnar Wigemark (shef i misionit të EULEX-it në Kosovë), riemëroi gjykatësen, Ekaterina Trendafilova, edhe për katër vjet, dhe ky emërim hyn në fuqi nga data 15 dhjetor 2020.

Sipas njoftimit, kryetarja Trendafilova shprehu mirënjohjen për "besimin që i është dhënë për të vijuar t'u shërbejë Dhomave të Specializuara të Kosovës të cilat kanë hyrë në një fazë të re dhe të rëndësishme me nisjen e proceseve gjyqësore".

Ajo deklaroi se ka besim që proceset do të kryhen në mënyrë të mbrojtur, të pavarur, të paanshme, të drejtë dhe efikase, në pajtim me mandatin e Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar janë krijuar pas miratimit nga

Kuvendi i Kosovës, në vitin 2015, të amendamentit kushtetues dhe legjislacionit për funksionalizimin e këtij institucioni gjyqësor.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar hetojnë krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 e deri në dhjetor të vitit 2000.

Në javën e parë të nëntorit të vitit 2020, Dhomat e Specializuara kanë konfirmuar akuzat ndaj ish-kryetarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, për krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit, duke i ngarkuar ata për "ndërmarrje të përbashkët kriminale".

Më 24 shtator, Salih Mustafa, ish-epror i UÇK-së është arrestuar dhe dërguar në Hagë. Aktakuza e ngarkon atë për kryerjen e krimeve të luftës.

Ish-pjesëtarët e UÇK-së, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj janë arrestuar më 25 shtator nga Dhomat e Specializuara të



Kosovës, ku më pas u transferuan në qendrën e ndalimit në Hagë. Gucati dhe Haradinaj dyshohen "për vepra penale kundër

administrimit të drejtësisë, përkatësisht për frikësim të dëshmitarëve, hakmarrje dhe shkelje të fshehtësisë së

procedurës".

Të gjithë të akuzuarit, gjenden në paraburgim në Hagë dhe janë deklaruar të pafajshëm.

Qeveria miraton kursimet dhe rishpërndarjen e mbi 47 milionë eurove për vitin 2020

PRISHTINË, 26 NËNTOR (ER)-Qeveria e Republikës së Kosovës, me kërkesë të kryeministrit Avdullah Hoti dhe në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë, ka mbajtur mbledhjen elektronike, në të cilën ka miratuar vendimin për kursime, ndarje dhe harmonizime në kategoritë e shpenzimeve të organizatave buxhetore për vitin 2020. Në njoftimin e qeverisë është bërë me dije se janë kursyer 47,621,459.91 euro dhe të njëjtat janë rishpërndarë nëpër organizata buxhetore. "Vendimi është miratuar sipas propozimit të Ministrisë së Financave, pasi që ka kaluar të gjitha fazat procedurale që janë

paraparë me Rregulloren e Punës së Qeverisë dhe me aktet tjera nënligjore. Në propozim është shqyrtuar i gjithë dokumentacioni me përmbajtjen e të gjitha të dhënave dhe informatave të nevojshme për miratimin e këtij vendimi. Propozimi është në përputhje edhe me Programin e Qeverisë dhe brenda afateve të parapara ligjore. Gjithashtu është harmonizuar me të gjitha ministrinë përgjegjëse, agjencitë dhe zyrat përkatëse, me të cilat janë kryer konsultimet për kursime, ndarje dhe harmonizime në kategoritë e shpenzimeve të organizatave buxhetore", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.



Reçica: Askush nuk do të mbetet pa shërbime sociale



PRISHTINË, 26 NËNTOR (ER)-Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka pritur të enjten në takim Valbona Çitaku, nga koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Viktimave nga Dhuna, njëherësh drejtoreshë e Strehimores së fëmijëve "Shpresa dhe Shtëpitë e fëmijëve" dhe Donjeta Kelmendi, drejtoreshë e koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF. Në këtë takim është diskutuar lidhur me angazhimin dhe punën e jashtëzakonshme që strehimorët në Kosovë kanë bërë në vazhdimësi, veçmas në këtë periudhë të vështirë pandemike, duke dhënë në çdo moment shërbime për fëmijët në nevojë. Ministri Reçica ka thënë se, është fakt që situata e ballafaqimit me Covid-19 e ka rënduar funksionimin e

mirëfilltë të mekanizmave që ofrojnë shërbime sociale, por pavarësisht kësaj, unë jam tejet i përkushtuar për t'i mbështetur dhe për të gjetur një zgjidhje afatgjate të financimit për ofruesit shërbimeve sociale. "Si ministër i MPMS-së, vazhdimisht kam bërë thirrje që çështja e financimit të rregullt të të gjithë atyre që ofrojnë shërbime sociale për fëmijët të rregullohet përmes Grantit Specifik për Shërbimet Sociale, mirëpo edhe në mungesë të kësaj, ne vazhdimisht kemi mbështetur financiarisht këto strehimore, për aq sa kemi pasur mundësi ligjore dhe financiare", ka thënë ministri i MPMS-së, Skender Reçica. Gjithashtu, ministri Reçica, ka siguruar se askush nuk do të mbetet pa shërbime sociale për shkak të mungesës së përkushtimit tim, si ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Subvencionimi i bizneseve nga qeveria, ATK-ja kërkon nga bizneset t'i përditësojnë të dhënat

PRISHTINË, 26 NËNTOR (ER)-Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka rikujtuar se tatimpaguesit që kanë pranuar njoftimin nga Ministria e Financave se janë përfitues të subvencioneve, do t'i pranojnë pagesat në ditët në vijim. Mirëpo, ATK-ja bënë me dije se ende disa nga këta tatimpagues nuk kanë përditësuar të dhënat e tyre në sistemin EDI, gjegjësisht evidentimi i llogarisë bankare në sistemin EDI nuk është i saktë. "Kjo mund të jetë edhe pasojë që disa nga tatimpaguesit edhe pse

kanë pranuar njoftimin nga Ministria e Financave nuk kanë përfituar ende nga subvencionet e qeverisë", thuhet në njoftimin e ATK-së. Andaj, ATK-ja ka kërkuar që të bëhet përditësimi i llogarisë bankare. "Edhe nëse paraprakisht keni bërë përditësimin e të dhënave dhe nuk keni përfituar ende nga subvencionet e qeverisë, kërkohet që të rishikoni edhe një herë të dhënat tuaja, pasi që është konstatuar nga Thesari se llogaria bankare ose mungon

ose llogaria që keni evidentuar në sistemin EDI nuk është e saktë dhe nuk është e mundur që t'ju rimbursohet ajo llogari për të përfituar subvencionet nga qeveria", ka njoftuar ATK-ja. Llogaria bankare që evidentoni në sistemin EDI duhet të jetë në emër të biznesit. "Pra, nëse llogaria bankare e juaj përditësohet dhe vendoset e saktë, Thesari i Kosovës do të bëjë pagesën në llogarinë tuaj, në afatin sa më të shkurtër", është thënë ndër të tjera në njoftimin e ATK-së.



Kosova anëtarësohet në rrjetin evropian GEANT

Një muaj pas krijimit të Rrjetit për Hulumtim dhe Edukim, Kosova është anëtarësuar në rrjetin evropian GEANT. “Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, përfshirë mua si ministër, është tejet e kënaqur që tashmë jemi pjesë e një rrjeti ndërkombëtar, që padyshim do të ndikojë edhe në avancimin e qasjes së studentëve tanë në tema shkencore dhe bashkërendim me botën perëndimore”, ka thënë ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi pas anëtarësimit të Kosovës në GEANT



EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 NËNTOR- Rrjeti Kombëtar i Kosovës për Hulumtim dhe Edukim është pranuar në Rrjetin Evropian GEANT, një nga rrjetet më të mëdha dhe më të avancuara hulumtuese dhe arsimore në botë që lidh më shumë se 50 milionë përdorues në 10,000 institucione në Evropë dhe që përkrahë të gjitha disiplinat shkencore.

Procedurat e nisura kohë më

parë dhe pasi një muaj më parë, ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, ka nënshkrua me 20 institucione publike dhe private të arsimit të lartë marrëveshje mirëkuptimi për Rrjetin për Hulumtim dhe Edukim të Kosovës dhe tash anëtarësimi është një përmbyllje e suksesshme brenda e këtij procesi. “Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, përfshirë mua si ministër, është tejet e kënaqur që tashmë jemi pjesë e një rrjeti ndërkombëtar,

që padyshim do të ndikojë edhe në avancimin e qasjes së studentëve tanë në tema shkencore dhe bashkërendim me botën perëndimore”, ka thënë ministri Kuçi.

Kërkesa nga Kosova është pranuar nga Asambleja e Përgjithshme e GEANT me shumicë votash. Tash hulumtuesit shkencorë, studentët dhe stafi i institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë mund të kenë qasje shumë të besueshme dhe të pakufizuar në llogaritje

kompjuterike, analiza, arkivim elektronik, aplikacione dhe burime tjera.

Ngritja dhe zhvillimi i Rrjetit Kombëtar të Kosovës për Hulumtim dhe Edukim dhe ndërlidhja e tij me GEANT janë pjesë e Projektit për Ekonominë Digjitale të Kosovës, të financuar nga Banka Botërore dhe të zbatuar nga Ministria e Ekonomisë e Kosovës. “Banka

Botërore do të vazhdojë të përkrahë Kosovën në forcimin e arsimit dhe infrastrukturës digjitale, që janë kritike për rritje ekonomike dhe krijim të vendeve të punës meqenëse ndihmojnë në thellimin e lidhjeve me ekonominë botërore”, ka thënë Massimiliano Paolucci, menaxher i Bankës Botërore për Kosovë.

Dështon mbledhja e komisionit për lejet e hidrocentraleve, shkak mungesa e deputetëve



PRISHTINË, 26 NËNTOR- Ka dështuar mbledhja e Komisionit Hetimor Parlamentar mbi procesin e licencimit, operimit, mbikëqyrjes dhe aplikimit për lejet e hidrocentraleve në

Republikën e Kosovës, shkak mungesa e kuorumit. Në plan të ditës ishte intervistimi i drejtorit të Departamentit të mjedisit dhe ujërave, Muhamet Malësiu dhe drejtori i Autoritetit të Rajonit të

Pellgjeve Lumore, Gani Berisha, si dhe kryetari Deçanit, Bashkim Ramosaj. Deputetja e PDK-së, Eliza Hoxha, ka thënë se shumë shpesh po ndodh që mos të ketë kuorum në mbledhje.

Ndërsa, deputetja nga radhët e AAK-së, Teuta Haxhiu, ka qenë interesuar të di se a do të mbahet edhe intervistimi i kryetarit të Deçanit në orën 14:00, për shkak se ajo ka thënë se kanë edhe obligime të tjera.

Deputetët e LV-së nuk kanë qenë të pranishëm në mbledhjen e komisionit, si dhe intervistimi i kryetarit të Deçanit që ishte paraparë të mbahet të enjten nuk është mbajtur.

Të gjitha zyrat komunale të Malishevës pajisen me material mbrojtës kundër Covidit

MALISHEVË, 26 NËNTOR (ER)- Në kuadër të zbatimit të masave mbrojtëse dhe manualit për mbrojtje në raport me Covid-19, të gjitha zyrat dhe institucionet tjera që janë në ombrellë të komunës, janë të pajisura me material mbrojtës ndaj Covid-19. Kështu ka bërë me dije drejtoresha e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme në Komunën e Malishevës, Besartë Kryeziu-Ramaj, e cila ka thënë se të gjitha zyrat apo objektet tjera, janë të pajisura mirë me material mbrojtës. “Të gjitha zyrat komunale dhe drejtoritë, janë të pajisura me material mbrojtës, si maska mbrojtëse, dezinfektues për

duar dhe alkool për dezinfektim. Po ashtu edhe objektet tjera që janë në ombrellë të komunës, siç është QKMF-ja dhe qendrat përcjellëse shëndetësore, muzeu i qytetit, biblioteka, salla e sporteve dhe të tjera, janë të pajisura me material mbrojtës”, ka thënë drejtoresha Besartë Kryeziu-Ramaj. Sipas saj, janë duke u zbatuar të gjitha udhëzimet dhe vendimet që vijnë nga niveli qendror përmes shtabit emergjent komunal. Ajo po ashtu kërkon nga qytetarët që të zbatojnë masat dhe udhëzimet e institucioneve përgjegjëse shëndetësore për t’u mbrojtur nga Covid-19.



Komuna e Prizrenit vazhdon punimet për rregullimin e rrugëve në fshatin Lubizhdë



PRIZREN, 26 NËNTOR (ER)- Drejtorja e Shërbimeve Publike (DSHP) në Komunën e Prizrenit po vazhdon intensivisht punimet për ndërtimin dhe rregullimin e rrugëve lokale në fshatin Lubizhdë. Me këtë rast,

drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Osman Krasniqi ka dalë në terren për të parë nga afër dhe për t’i inspektuar punimet që po realizohen në kuadër të këtij projekti, ku do të bëhet shtrimi i rrugëve me kubëza

dhe kufizimi i tyre me skajore. Komuna e Prizrenit ka njoftuar se do të vazhdojë punën për ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore edhe në fshatrat dhe lagjet tjera të qytetit.

Nënkryetari Rudari vizitoi familjen që iu ndërtua shtëpia e re në Siboc

Podujevë, 26 nëntor (ER)- Nënkryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, të enjten ka vizituar familjen e Fitim Sejdiut, nga fshati Siboc, për t’i uruar shtëpinë e re. Kjo shtëpi u ndërtua falë zemërgjerësisë së një donatori, për të cilin kjo është

shtëpia e dhjetë që po ndërton në Komunën e Podujevës dhe i cili dëshiron të mbetet anonim. “Kjo është shtëpia e 53-të që është ndërtuar sivjet nga Komuna e Podujevës dhe në bashkëpunim me partnerë dhe donatorë”, ka thënë nënkryetari Rudari.



Lladrovci ngushëllon familjen Krasniqi për vdekjen e nënës së dëshmorit Fatos Krasniqi

DRENAS, 26 NËNTOR (ER)- Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci ka ngushëlluar familjen Krasniqi nga Negroci, për vdekjen e Mana Krasniqi, nëna e dëshmorit Fatos Krasniqi dhe bashkëshortja e Sherif Krasniqit, ish-nënkryetari i komunës, kryetar i SHV-së dhe ish i burgosur politik. Kryetari Lladrovci mes të tjerash ka theksuar se nënat e

heronjve janë vërtetë heroina, të cilat kanë dhënë shumë për luftën dhe lirinë e këtij vendi. “Me dhimbje pranuar lajmin për vdekjen e Mana Krasniqi, nëna e dëshmorit Fatos Krasniqi. Ajo është shembull i një heroine, të cilës iu flijua djali në altar të lirisë për atdheun. Ngushëllime të sinqerta familjes Krasniqi”, ka thënë Lladrovci.



Dosja e krimeve serbe në valixhet e shqyera të Kosovës!

Sikur politika, institucione dhe shoqëria e Kosovës të punonin dhe të koordinonin aktivitetet rreth përpilimit të një dosje voluminoze mbi krimet serbe, askujt në Beograd, as në Bruksel nuk do t'i shkonte në mendje të merrej me krimet e supozuara dhe të hamendësuara të shqiptarëve të Kosovës. Prandaj nevojitet urgjentisht aktivizimi i të gjitha resurseve shtetërore e shoqërore në procedimin krimeve serbe të kryera në Kosovë, sepse vetëm në këtë mënyrë zhurma false e procesit në Hagë kundër ish krerëve të UÇK-së do të humb në detin e madh të masakrave e dhunimeve serbe



Nga Mehmet PRISHTINA

Nevoja për të monopolizuar lavdinë e luftës përmes botimit të librave të ndryshme, ku në qendër të vëmendjes kanë qenë individë të caktuar, zakonisht të veshur me pushtet, e ka zhvendosur totalisht vëmendjen e opinionit publik, duke krijuar një pasqyrë të rrejshme se këtu ka pas vetëm lavdi, por jo dhe viktima dhe sakrificë. Nga kjo mënyrë e paraqitjes së njëanshme të narrativave mbi luftën e fundit në Kosovë, Serbia

ka dalë të jetë përfituesja më e madhe, për arsye se kundër saj askush nga Kosova nuk ngriti ndonjë padi në gjykatat ndërkombëtare. Lavdia e mbështjellë me marketing politik e ka larguar Kosovën nga beteja ndërkombëtare e drejtësisë dhe për pasojë shumë vrasje, dhunime, masakra, djegie e shkatërrime kanë ngelë vetëm shkronja të vdekura në disa libra të cilat ma tepër kanë promovu autorë të caktuar se sa që kanë provuar të nxjerrin në bankën e të akuzuarve kriminelët serbë. Paradoksalisht, për krime të bëra në Kosovë nga ana e serbëve të caktuar, më shumë janë angazhuar shoqata e individë të ndryshëm në Beograd se sa në Kosovë. Mjafton të përmendim Fondin për të Drejtën Humanitare si

dhe zonjat Natasha Kandiq e Sonja Biserko, të cilat dosjet mbi krimet serbe në Kosovë i bën publike, duke zbuluar shumë të vërteta të hidhura mbi kamionët me frigoriferë të mbushur (dhe të zhdukur) me trupa shqiptarësh të vvarë si dhe dhjetëra varreza masive, ekzistimi i të cilave ende rëndon mbi politikën e padrejtë serbe. Aktualisht në një Gjykatë Speciale në Hagë mbahen në paraburgim disa ish-krerë të UÇK-së. Ditëve të fundit kemi pas rastin të shohim e lexojmë një mori deklarata patetike mbi padrejtësinë që po i bëhet Kosovës përmes këtij procesi gjyqësor, por a mjafton të themi se ata janë të pafajshëm, ndërkohë që pafajësinë e tyre vazhdojmë ta trajtojmë si konsum të brendshëm. Shoqëria kosovare edhe 21 vite pas

përfundimit të luftës nuk ka pushuar së zhvilluari beteja të brendshme absurde, ndërkohë që Serbia dhe aleatët e saj në Rusi dhe në Europë me mjeshtëri arritën ta shtrembërojnë dioptrinë mbi Kosovën, duke e paraqitur atë si një "bankomat" ku mund të shlyhen disa kusure nga e kaluara.

Krijimi i Gjykatës Speciale në Hagë është kompensim i dështimeve të sistemit të drejtësisë, i komanduar me vite nga UNMIK-u dhe EULEX-i. Krijimi i Gjykatës Special në Hagë është edhe një tentim jo i lavdishëm nga ana e segmenteve të caktuara të politikës evropiane për të korrigjuar disa qëndrime nga e kaluara ndaj Kosovës, duke i rikthyer Serbisë terrenin e humbur moral në fushën diplomacisë dhe politikës ndërkombëtare. Dëshmi për këtë është raporti i Dik Martyt, (i frymëzuar kryesisht nga sajimet ruse e serbe mbi Kosovën) nga ish anëtari i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe ish-prokuror i shtetit i kantonit të Tiçinos në Zvicër, mbi të cilin u miratua edhe një Rezolutë e Këshillit të Evropës, që i hapi dritë jeshile ngritjes së Gjykatës Speciale të

Kosovës me seli në Hagë.

Por, paradoksalisht, edhe pse u pat premtuar se do të ngrihet padi ndaj zvicëranit Dik Martyt, ajo nuk ndodhi kurrë. Në vend të kësaj ndodhi bumerangu. Tani në Hagë ndodhet një pjesë e ndërgjegjes kolektive të Kosovës për politikën pa strategji kundrejt krimeve serbe të kryera në Kosovë. Sikur politika, institucione dhe shoqëria e Kosovës të punonin dhe të koordinonin aktivitetet rreth përpilimit të një dosje voluminoze mbi krimet serbe, askujt në Beograd, as në Bruksel nuk do t'i shkonte në mendje të merrej me krimet e supozuara dhe të hamendësuara të shqiptarëve të Kosovës. Fatkeqësisht dosja krimeve serbe mbeti e humbur në valixhet e shqyera të politikës së Kosovës.

Tani është tepër vonë të tregojmë me gusht fajtorët, por ajo çka kërkohet aktualisht është aktivizimi i të gjitha resurseve shtetërore e shoqërore në procedimin krimeve serbe të kryera në Kosovë, sepse vetëm në këtë mënyrë zhurma false e procesit në Hagë kundër ish krerëve të UÇK-së do të humb në detin e madh të masakrave e dhunimeve serbe.

Deputetët dhe subjektet politike duhet të jenë unikë



Shkruan: Hasan JASHARI

Sot vendi ynë gjendet në një situatë të rëndë në të gjitha poret e jetës. Deputetët e zgjedhur të popullit në Parlamentin e Kosovës nuk po kanë unitet dhe nuk po arrijnë të votojnë asnjë ligj, as atë për rimëkëmbjen ekonomike, i cili është shumë i rëndësishëm për qytetarët e Republikës së Kosovës. Shteti ynë ka shumë sfida përpara. Gjendemi një situatë të rëndë edhe me pandeminë Covid-19 e cila ka kapluar botën. Në vendin tonë çdo ditë po rëndohet gjendja shëndetësore e qytetarëve me këtë pandemi dhe po rritet numri i të vdekurve.

Na pret një temë shumë e rëndësishme për përfundimin e dialogut me Serbinë. Tani Prokuroria në Hagë ka ngritur

disa aktakuza ndaj udhëheqësve të luftës së UÇK-së. Gjykata e Dhomave të Specializuara me seli në Hagë ka caktuar paraburgim ndaj disa prej udhëheqësve të luftës së UÇK-së. Kjo prokurori dhe gjykatë është shumë e padrejtë, e njëanshme, e cila është formuar vetëm për një etni dhe me këtë vendi ynë po sfidohet.

Janë paraburgosur themeluesit e UÇK-së, ish-presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentari, Jakup Krasniqi, ish-kryeparlamentari dhe kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, kryetari i grupit parlamentar të LV-së, Rexhep Selimi, dhe udhëheqësit e shoqatave të dala nga lufta e lavdishme e UÇK-së.

Dihet botërisht se UÇK-ja ka bërë një luftë të drejtë, të pastër, luftë mbrojtëse, që është impunuar nga dhuna sistematike e serbëve. I tërë populli u rreshtua në radhët e UÇK-së. Me këto arrestime të padrejta është dëmtuar imazhi i shtetit të Kosovës, ku Serbia përmes kësaj gjykate po tenton të ndryshojë rolet duke u paraqitur si viktimë, e neve na

llogarisin si kryerësit e krimeve e në realitet e tërë bota e dinë se ne ishim viktima. Serbia ka bërë qindra krime, gjenocid dhe spastrim në Kosovë.

Sot kemi një numër të madh të të pagjeturve, kështu sot vendi ynë po pëson një goditje të madhe, e këtë goditje duhet ta kthejmë në forcë. Sot në Kosovë kërkohet unitet nga të gjitha subjektet politike, në mënyrë që t'i bëjmë funksionale institucionet e vendit.

Unë si qytetar i Republikës së Kosovës, si familje e dëshmorit të kombit, si ish-veteran luftëtar i UÇK-së, si pjesëtar i lagjes Jashari dhe me profesion avokat, e kam një apel për deputetët e Kuvendit të Kosovës, të cilët i kemi votuar vetë dhe sot na përfaqësojnë, për subjektet politike të vendit, që t'i lënë anash inatet, interesat personale, grupe dhe partiake, dhe të bëhen të gjithë bashkë për ndërtimin e shtetit dhe institucionet e vendit t'i bëjnë funksionale dhe të mendojnë se zgjedhjet në këtë moment nuk janë zgjidhje për vendin.

T'ju tregojmë miqve ndërkombëtarë se ne dimë ta

ndërtojmë shtetin tonë, se jemi shtet dhe mundemi të funksionojmë si shtet. Pra të tregohemi të mençur, të dijshtë, të fortë dhe para se gjithash unik në këto ditë të vështira, ku historia na ka treguar se sa herë kemi qenë unik kemi dalë fitues.


Vetëm kështu e qojmë në vend obligimin ndaj gjakut të dëshmorëve të kombit, martirëve dhe invalidëve të cilët i kanë dhënë gjymtyrët e trupit për lirinë e vendit, Po ashtu, vetëm të bashkuar e

respektojmë sakrificën e madhe të tërë popullit shqiptar.

Sot populli i Kosovës, më të drejtë pret një unitet të plotë të subjekteve politike, të pozitës dhe opozitës, të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, duke përfshirë edhe minoritetet me përjashtim të Listës Serbe, që të përfundojë shtetndërtimi i Kosovës, në mënyrë që të zhvillohet vendi ynë.

***Autori është avokat nga Prekazi i Poshtëm i Komunës së Skenderajt**





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Kosova pëson humbje nga Sllovakia



PRISHTINË, 26 NËNTOR - Kosova ka pësuar humbje nga Sllovakia me rezultat 91:67 (21:9, 21:20, 20:13, 29:25), në kuadër të parakualifikimeve evropiane për Kupën e Botës 2023. Mungesa e disa basketbollistëve të "dardanët" dhe shtatëlartësia e kundërshtarëve, bëri që Kosova të pësojë humbjen e parë në dritaren e parë të parakualifikimeve. Vendasit e nisën ndeshjen më mirë, duke hyrë në një seri prej 11:0. Por, "dardanët" u kundërpërgjigjën me gjashtë pikë radhazi për 11:6. Më pas sllovakët kontrolluan lojën dhe përfunduan çerekun e parë në të mirë të tyre 21:9. Në

periudhën e dytë zhvillohet lojë e baraspeshuar, me "dardanët", që kësaj radhe u treguan 'arrë e fortë' për sllovakët. Kjo pjesë përfundoi 21:20, derisa rezultati pas pjesës së parë ishte 42:29. Pjesën e dytë e nisi shumë mirë Kosova me një epërsi 4:9, por vendasit përgjigjën me tetë pikë radhazi. Më pas zhvillohet një lojë e barabartë, por në fund të periudhës së tretë kishte një rënie të Kosova dhe rezultati në semafor pas 30 minutave ishte 62:42. 10 minutat e fundit ishin vetëm formalitet, ku përkundër disa gjuajtjeve të sakta për tri pikë të Kosovës, "dardanët" nuk arritën të bëjnë më shumë dhe pësuan në fund 91:67. Te

Sllovakia më i miri ishte Vladimir Brodziansky me 26 pikë e 12 kërcime, kurse te Kosova më të dalluarit ishin Drilon Hajrizi me 17 pikë, 5 kërcime, 6 asistime, Erjon Kastrati me 14 pikë dhe Fisnik Rugova me 11 pikë e 7 kërcime. Në ndeshjen tjetër të Grupit B, Islanda ka mundur Luksemburgun 90:76. Sllovakia, Islanda dhe Kosova kanë grumbulluar nga pesë pikë, kurse Luksemburgu ndodhet e fundit me tri pikë. Ndeshja e ardhshme për Kosovën do të jetë më 28 nëntor, nga ora 16:00 me Islandën, takim që po ashtu do të zhvillohet në Bratislavë.

SHKURT

Liverpooli mund ta shes Shaqirin në janar

Xherdan Shaqiri duket se nuk ka të ardhme në Liverpool. Andaj përfaqësuesi i Zvicrës mund të shitet në afatin kalimtar të janarit. Kështu raporton Express.co.uk, duke shtuar se trajneri Jurgen Klopp ka në plan që të arkëtojë mjete nga shitja e Shaqirit dhe Divock Origi. Të dy kanë hasur në probleme për t'u paraqitur për "The Reds", ndaj klubi synon që nga secili të përfitojë nga 15 milionë euro.

Muriqi mundon dy javë

Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës, Vedat Muriqi do të jetë të paktën dy javë jashtë fushës shkak i lëndimit gjatë ndeshjes që Lazio e fitoi të martën ndaj Zenitit në kuadër të fazës së grupeve të Ligës së Kampionëve. Kështu ka raportuar të enjten "La Lazio Siamo Noi". Muriqi u inkuadrua në fushë në minutën e 80-të dhe pati disa duele me mbrojtësit e Zenitit. Ai do t'i mungoj Lazios në ndeshjen kundër Udineses, Borussia Dortmundit dhe Spezias. Sulmuesi 26-vjeçar nga Prizreni ka luajtur katër ndeshje në Ligën e Kampionëve dhe katër në Serie A.

KF Laçi shkarkon trajnerin

KF Laçi, ka ndarë rrugët me trajnerin e tyre Armando Cungu pas rezultateve negative që ka pasur klubi nën drejtimin e tij. Tre pikë në katër ndeshjet e fundit nuk është standard për një ekip që dëshiron të konkurrojë për titullin kampion, kanë cilësuar drejtuesit e klubit. Mësohet se trajneri dhe klubi janë pajtuar për ndërprerjen e bashkëpunimit. Ishte vet trajneri Cungu, i cili konfirmoi largimin e tij për "Abcnews.al". Armando Cungu largohet nga Laçi pas një viti rekord ku regjistroi 21 fitore, 7 barazime dhe 10 humbje në 38 ndeshje gjithsej.

Kabashi: AEK-u është favorit, por ne nuk dorëzohemi

Shorti i së mërkurës nuk ishte shumë i favorshëm për KH Prishtinën, që në raundin e tretë të Kupës Evropiane përballat me AEK-un e Athinës. AEK-u ka përbërje të fortë me plot lojtarë të huaj dhe vlerësohet prej skuadrave më të forta në këtë garë. Në vitin 2018 luajti në finale të Kupës Sfiduese kurse në gara evropiane paraqitet rregullisht. Ndeshja e parë luhet më 12 dhjetor në Athinë kurse e kthimit më 19 dhjetor në Prishtinë. Trajneri i Prishtinës, Taib Kabashi ka premtuar maksimumin në përpjekje për të kaluar ekipin grek. "AEK-u i Athinës është kundërshtari më i fortë i mundshëm. Bëhet fjalë për ekip shumë të mirë, që ka në radhët e tij lojtarë nga Spanja, Kroacia, Serbia, Brazili dhe lojtarët më të mirë vendor. Fati jonë është që lojën e parë e zhvillojmë në Greqi e të dytën në Prishtinë. Në sport asnjëherë nuk i dihet. Do të japim maksimumin, me të gjitha forcat që kemi", ka thënë Kabashi.

Ballkani mposhti Drenicën

SKENDERAJ, 26 NËNTOR - Liderja e Superligës në futboll, Ballkani ka shënuar fitoren e radhës në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj ndaj

Drenicës (2-1). Pas tre minutave lojë, Eral Krasniqi e kaloi Ballkanin në epërsi, derisa për 0-2 u përkujdes Mirlind Daku, i cili

realizoi në minutën e 29-të. Një minutë pa përfunduar koha e rregullt e ndeshjes, Azem Bejta shënoi golin e vetëm për skuadrën kuqezi.

Pas kësaj ndeshje, Ballkani është në vendin e parë me 32 pikë. Drenica mbetet në kuotën e 18 pikëve dhe renditet në pozitën e pestë.



Antetokounmpo: Mund të luaj për Milwaukee edhe shumë vite

MILWAUKEE, 26 NËNTOR - Giannis Antetokounmpo, MVP i dy sezoneve të fundit në NBA, ka rrëfyer se mund të qëndrojë për shumë sezone te skuadra e Milwaukee Bucks. Në dy sezonet e fundit, ky ekip ka arritur rekordin më të mirë në sezonin e rregullt, por më pas

ka zhgënjyer në fazën "play-off". Ndërkohë që, për lojtarin grek ofertat nuk kanë munguar, duke i ofruar mundësinë të duelojë për titull. "Kohët e fundit kam dëgjuar shumë zëra, të gjithë kanë mendimin e tyre", ka thënë Giannis. "Unë do të bëj zgjedhjen më të mirë për mua e

familjen time. Nuk i kuptoj zërat se duhet të largohem që këtu. Unë mund të qëndroj te Milwaukee për shumë vite. Për sa kohë ky ekip do të jetë në të njëjtin nivel me rivalët dhe duelojmë për titull, gjithçka do të jetë OK edhe për mua. Nëse gjërat do të përkeqësohen,

atëherë edhe mund të largohem. Është e thjeshtë, unë dua të jem një fitues, për mua nuk kanë shumë rëndësi paratë. Për sa kohë fitojmë dhe krijojmë një kulturë fituese, do të qëndroj dhe gjërat do të shkojnë mirë", ka shtuar Antetokounmpo.



I jepet lamtumira Diego Armando Maradonës



BUENOS AIRES, 26 NËNTOR - Qindra mijëra argjentinas kanë bërë homazhe pranë arkivolit që mbante trupin e pajetë të Diego Armando Maradonës. Ceremonia po mbahet në pallatin presidencial. Që prej orëve të para të mëngjesit mijëra qytetarë u grumbulluan për të bërë nderimet e fundit idhullit të tyre. Grumbullimi masiv u menaxhua me vështirësi nga forcat e policisë dhe ato kundër protestave. Pati momente të cilat u kthyen

realisht në protestë pasi të shumë ishin ata që kërkonin të futeshin në ambientet ku po mbahej ceremonia e homazheve. Perëndia e futbollit, siç e quanin ndryshe argjentinasit adhurohej jo vetëm brenda kufijve të atdheut të tij. Ai pati një karrierë të gjatë që kulmin e pati me fitoren e kupës së botës në 1986. Një lavdi që u arrit me meritë, spektakël dredhi dhe shumë emocione. Në vitet e fundit Maradona kishte shumë probleme

shëndetësore si pasojë e varësive të tij, të trashëguara nga koha kur ishte futbollisti më i mirë në botë. Dy javë më parë ai u shtrua në spital pasi u diagnostikua me anemi dhe dehidratim. Iu nënshtua një operacioni të vështirë dhe delikat në tru për shkak të një hematome. Megjithatë në karakter dhe mentalitet ai ishte gjithnjë energjik, fiziku i tij prej vitesh nuk i përgjigjej. Shtimi i peshës për shkak të abuzimeve ndikoi jo pak në shëndetin e tij.

Avokati i Maradonas kërkon të hetohet vdekja e legjendës

BUENOS AIRES, 26 NËNTOR - Avokati i Diego Maradonas, Matias Morla, kërkon që të bëhet hetim lidhur me vdekjen e legjendës argentinase. Ikona e futbollit botëror ka vdekur të mërkurën si pasojë e sulmit në zemër, ndërsa avokati i tij nuk dëshiron që të anashkalohej ajo që e quan "krim të pashpjegueshëm dhe idiot". "Sot është një ditë e vuajtjes së madhe, pikëllimit dhe reflektimit", ka thënë Morla në një komunikatë zyrtare që transmetohet nga "Calciomercato.com". "E ndjej në zemër humbjen e një mikut, të cilin e kam respektuar me besnikëri deri në ditën e fundit. E kam përshëndetur personalisht, funerali duhet të



jetë një moment privat dhe familjar. Në bazë të asaj që ka thënë prokurori i San Isidro, është e pashpjegueshme që për 12 orë, Diego nuk ka pasur vëmendje ose kontroll nga personeli mjekësor. Ambulancës iu desh më shumë

se gjysmë ore për të arritur, ishte një krim idiot. Ky fakt nuk duhet të kalojë pa u vërejtur dhe ju kërkoj që ta hetoni deri në fund. Siç më ka thënë Diego: "Ti je ushtari im, i cili punon pa mëshirë", kanë qenë fjalët e avokatit të Maradonas.

SHKURT

Trajneri Grima rezulton pozitiv me Covid-19

Koronavirusi vazhdon të përhapet me shpejtësi në mbarë botën. Këtij virusi që po bën kërdinë kudo, nuk i kanë shpëtuar as personazhe të botës së sportit. Së fundmi mediat lokale në Shkodër kanë raportuar se trajneri i Kombëtares së femrave, Armir Grima ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Ish-portieri shkodran, kreu testet ditën e djeshme, teksa të enjten mësoi edhe përgjigjen pozitive. Një lajm aspak pozitiv ky, teksa kujtojmë që Kombëtarja e femrave do të luajë të premten në "Loro Boriçi", në sfidën ndaj Qipros, e vlefshme për eliminatorët.

Formacioni i javës në Ligën e Kampionëve

Është zgjedhur formacioni i javës në Ligën e Kampionëve. Kjo javë ka sjellë ndeshje mjaft interesante ku nuk munguan as befasishtë. Votuesit e Ligës së Kampionëve kanë votuar tashmë dhe kanë zgjedhur formacionin më të mirë të javës. Klubi me më shumë lojtarë është Borussia Monchengladbach me tre sosh, ndërsa pas tyre vjen Barcelona me dy lojtarë. Lokomotiva e Moskës, Atalanta, Porto, Manchester Unitedi, Lazio dhe Bayern Munichu kanë nga një lojtarë. Formacioni: Guilherme Marinato; Oscar Wendt, Nico Elvedi, Zaidu Sanusi; Sergino Dest, Bruno Fernandes, Lars Stindl, Kingsley Coman, Robin Gosens; Martin Braithwaite, Ciro Immobile.

Zidane: Nuk mund të fitosh gjithmonë duke luajtur bukur

Real Madridi e tregoi fuqinë ndaj Interit, duke fituar pastër me shifrat 0-2 dhe dominuar edhe në lojë. Trajneri i "Los Blancos", Zinedin Zidane është shfaqur i kënaqur për fitoren dhe i dha meritën futbollistëve për këtë triumf shumë të rëndësishëm për klubin mbretëror. "Ishte ndeshje e rëndësishme, e përgatitëm mirë. E dinim se do të ishte e vështirë, por kemi luajtur me karakter dhe kemi pasur qasjen e duhur në fushë. Jam i lumtur për lojtarët sepse ata shpesh kritikohen kur paraqitjet tona nuk janë të shkëlqyera. Nuk mund të fitosh gjithmonë në futboll, e rëndësishme është të japësh gjithçka ke çdo herë dhe kjo është ajo që bëjmë. Duam të luajmë gjithmonë futboll të bukur dhe të marrim fitoret, por nuk është gjithmonë e mundur", ka thënë Zidane.

Villas Boas: FIFA të tërheqë fanellat me numrin 10

Asnjë futbollistë nuk do të mbajë të veshur fanellën me numër 10. Ky është propozimi i trajnerit të Marsejës, Andre Villas Boas për të nderuar Diego Armando Maradonan, i cili ndërroi jetë të mërkurën. "Është një lajm i trishtë. Propozoj që FIFA të tërheq fanellën me numrin 10 në të gjitha kompeticionet dhe në të gjitha skuadrat. Do të ishte homazhi më i mirë që mund të bëjmë. Një humbje e pabesueshme për futbollin", ka thënë strategu i njohur.

Klopp: Ishte humbje e merituar për Liverpoolin

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, e ka pranuar se ekipi i tij e meritoi humbjen të mërkurën kundër Atalantës në Ligën e Kampionëve (0-2). Kjo ishte humbja më e thellë e Kloppit në "Anfield" si trajner dhe për më tepër të kuqtë dështuan ta regjistronin qoftë edhe një goditje të vetme në kornizën e portës. "Nuk ishte ndeshje e mirë. Të dy ekipet nuk krijuan shumë deri në çastin kur u shënuan golat. Ishte humbje e merituar në një ndeshje të vështirë. Gjyqtari nuk i ra pipit shpesh dhe kjo e bëri edhe më të vështirë për të dy skuadrat. Ne i patëm çastet tona por nuk krijuam shanse", ka thënë Klopp.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 10, paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rishpall:

KONKURS

Për zgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga komunitetet joshqiptare

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (Këshilli) është organ i pavarur që i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe i cili vendos për ankesat e nëpunësve, si dhe siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

Përbërja e Këshillit

Këshilli përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve që zgjedhën nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Prej tyre, së paku dy (2) anëtar zgjedhën nga komunitetet joshqiptare dhe së paku dy (2) anëtar duhet të jenë të gjinisë femërore.

Funksionet e Këshillit :

- Mbikëqyr zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil;
- Shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil;
- Mbikëqyrë procedurën e përzgjedhjes dhe vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil;
- Monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Kandidati që aplikon për tu zgjedhur anëtar i Këshillit duhet të ketë kualifikimet dhe të plotësojë kriteret në vijim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë diplomë të fakultetit juridik të vlefshme sipas ligjit në fuqi;
- Të ketë së paku dhjetë (10) vite përvojë pune profesionale, prej të cilave së paku pesë (5) vite përvojë pune në shërbimin civil;
- Të ketë të kryer provimin e jurisprudencës;
- Të jetë njohës mirë i legjislacionit në fuqi;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil me vendim përfundimtar.

Mandati i anëtarëve të Këshillit

- Anëtarët e Këshillit zgjedhën për mandat shtatë (7) vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes për mandat tjetër.
- Anëtari i Këshillit nuk ka të drejtë që gjatë mandatit të tij të ushtrojë ndonjë funksion tjetër shtetëror, të jetë anëtar i partisë politike apo të marr pjesë në aktivitete politike.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale;
- Letra motivuese;
- Curriculum Vitae (CV - autobiografia);
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale.

PROCEDURA E KONKURIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 16.12.2020, në orën 16:00.

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:

Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtoria e Personelit, Zyra N-217);

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

Forma elektronike: faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038/ 211-182, 038/ 211-648 dhe 044/ 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara.

Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Skupština Republike Kosova, na osnovu člana 10, Zakona br. 06/L-048 o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova ponovo raspisuje:

KONKURS

Za izbor dva (2) člana Nezavisnog nadzornog odbora za Civilnu službu Kosova, iz ne albanske zajednice

Nezavisni nadzorni odbor za civilnu službu Kosova (Odbor) je nezavisni organ, koji izveštava Skupštini Republike Kosova, rešava žalbe zaposlenih i obezbeđuje poštovanje pravila i načela koja regulišu civilnu službu.

Sastav Odbora

Odbor se sastoji od (7) članova, koje bira Skupština Republike Kosova.

Od toga, najmanje (2) člana biraju se iz ne albanskih zajednica i najmanje (2) člana treba da budu ženskog pola.

Funkcije Odbora:

- Nadgleda primenu pravila i načela zakonodavstva o civilnoj službi.
- Razmatra i rešava žalbe civilnih službenika i kandidata za prijem u civilnu službu.
- Nadgleda proceduru izbora i odlučuje da li su imenovanja civilnih službenika visokog upravnog nivoa i upravnog nivoa, odvijane u skladu sa pravilima i načelima zakonodavstva o civilnoj službi;
- Nadgleda institucije javne administracije, koje su zaposlile civilne službenike u vezi sprovođenja pravila i načela zakonodavstva o civilnoj službi;

Kandidati koji apliciraju za izbor člana Odbora, mora da budu kvalifikovani i da ispunjavaju sledeće kriterijume:

- Da je državljanin Republike Kosova,
- Da je diplomirani pravnik, prema važećem zakonodavstvu, koje je na snazi;
- Da poseduje najmanje 10 (deset) godina stručnog radnog iskustva, od kojih najmanje 5 (pet) godina rada u civilnoj službi,
- Da je završio pravosudni ispit;
- Da je dobar poznavalac važećeg zakonodavstva,
- Da nije kažnjavan pravosnažnom odlukom za počinjeno namerno krivično delo;
- Da prema njemu nije konačnom odlukom preduzeta disciplinska mera udaljavanja iz civilne službe.

Mandat članova Odbora

- Članovi odbora se imenuju za sedmogodišnji (7) mandat, bez mogućnosti ponovnog izbora za još jedan mandat,
- Član odbora nema pravo da u toku svog mandata obavlja drugu državnu funkciju, da bude član političke partije ili da učestvuje u političkim aktivnostima.

Uz aplikaciju moraju se priložiti sledeća propratna dokumenta

- Dokaz o školskoj i profesionalnoj spremi,
- Motivaciono pismo,
- Curriculum Vitae (CV-autobiografija),
- Dokaz da je državljanin Republike Kosova.
- Dokaz o radnom iskustvu,
- Dokaz da nije kažnjavan za krivično delo.

PROCEDURA KONKURISANJA

Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 16.12.2020. godine u 16:00 časova.

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu:

Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:

Štampana forma: u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul. „Majka Tereza“ bb. ili u

Elektronskom obliku: internet-stranica Skupštine Republike Kosova - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana u 16:00 časova, na brojeve telefona: 038/211-182, 038/ 211-648 i 044/ 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta.

Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažećim.

NJOFTIM

